

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Nexhmedin Demolli nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim K.P. nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.558/2015, të datës 27.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.558/2015, i datës 27.06.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” sh.a., me seli në Prishtinë, ashtu që në pikën I të dispozitivit ka detyruar palën e paditur Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria, me seli në Prishtinë, në emër të zhdëmtimit në bazë të regresit, t’ia paguaj paditëses shumën prej 437.45 €, me kamatë në lartësi prej 12%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë, përkatësisht data 10.12.2015 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses në shumën prej 235.55 €, ndërsa në pikën III të dispozitivit ka detyruar palën e paditur që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj palës paditëse shumën prej 265.10 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” sh.a., me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, padi kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që në emër të zhdëmtimit në bazë të regresit, i padituri të kompensoj shumën prej 673.00 €, së bashku me kamatën ligjore, duke filluar nga data 18.02.2014, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, meqenëse i padituri e ka pranuar pjesërisht përgjegjësinë për kompensimin e dëmit, por vetëm ndarja e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit të makinerisë për vlerësimin e dëmit, S.B., të dhënë në ekspertizën e datës 19.05.2016, sipas të cilit ka rezultuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve teknike nga ana e të dy ngasësve të automjeteve të involvuara në aksident , ku ngasësi i automjetit Opel Pickup, i siguruari i të paditurit, ka bërë lëvizje të rrezikshme, pra është ngutur për ndërrimin e shiritit të komunikacionit majtas, nëpër vijë të plotë, para udhëkryqit, i është afruar shumë automjetit C, ndërsa ngasësi i automjetit VË Polo, i siguruar te paditësja ka lëvizur me shpejtësi joadekuate në vendbanim, ku shpejtësia është e kufizuar në 40 km/h dhe nuk e ka respektuar distancën e sigurisë. Kështu nga ana e ekspertit është konkluduar se shkaktar i aksidentit ka qenë i siguruari i të paditurit ndërsa kontribut sekondar ka dhënë i siguruari i paditëses. Andaj pasi që përgjegjësia për dëmin ishte e ndarë, gjykata e shkallës së parë e vlerësoi se kjo përgjegjësi i takon 65% të paditurit dhe 35% paditëses, që në rastin konkret i bie, që nga shuma e kërkuar me kërkesëpadi prej 673.00 €, të hiqet 35% dhe shuma rezulton të jetë në vlerë prej 437.45 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se drejtë janë zbatuar dispozitat e nenit 26 pika 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në bazë të së cilit, gjykata e shkallës së parë e detyroi të paditurin që t'i paguaj paditësit, shumën e gjykuar të kompensimit si dhe normën e kamatës në lartësi prej 12%, nga data 10.12.2015, pasi që i padituri kishte rënë në vonesë lidhur me pagesën e dëmit të shkaktuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sa i përket shpenzimeve procedurale dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 452. par.1, të LPK-së, sepse shuma e aprovuar për shpenzime procedurale nuk përfshin shpenzimet për përfaqësime në seanca të përfaqësuesve, por shpenzimet për përpilimin e padisë, shpenzimet e ekspertizës dhe taksat gjyqësore.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.224/2016, dt.09.11.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.